**VENDIM**
**Nr.1057, datë 16.7.2008**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS MOLLAJ, TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Mollaj, të qarkut të Korçës, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Mollaj, të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr.794, datë 16.11.2006 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Mollaj, të qarkut të Korçës".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Mollaj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendimi hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Komuna Mollaj Lidhja nr.1

| **Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit** | **Fusha e përdorimit të pronës** | **Lloji i transferimit** |
|---|---|---|
| | | |
| 19-21 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e administratës | Në pronësi |
| 1-5 | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore | Në pronësi |
| 13-18 | Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive | Në pronësi |
| 6-12 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shëndetësisë | Në pronësi |
| 22-29 | Varrezat publike | Në pronësi |
| 30-32 | Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji | Në përdorim |
| 33 | Prona që përdoren për | Në pronësi |

| | | |
|---|---|---|
| | ushtrimin e funksioneve në fushën e shërbimit social | |
| 179-263 | Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike) | Në pronësi |
| 264-270 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve | Në pronësi |
| 52 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik | Në pronësi |
| 34-36,38-40,42,43,46,48-50 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive) | Në përdorim |
| 37,41,44,45,47,51,156,157, 162,168,170,176,339,340 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive) | Në pronësi |